



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga "Abdi Toptani", ish- hotel "Drini", Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 1754 Prot.

Tiranë, më 31.10.2017

V E N D I M

Nr. 219, datë 31.10.2017

“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit që përmban shkresa e protokolluar pranë KMSHC me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, nga punonjësi **, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar”, në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej punonjësit *****, regjistruar me nr. 1563 prot., datë 28.08.2017, ka marrë dijeni në lidhje me pretendimet për moslejimin nga ana e eprorit për kryerjen e detyrës së tij funksionale si Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë, si dhe ndërprerjen e pagës që nga muaji Qershor 2017.

Për këtë arsye, bazuar në Urdhrin e verifikimit nr. 1563/1 Akti, datë 12.9.2017, “Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa e punonjësit *****, protokolluar me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, në lidhje me moslejimin për kryerjen e funksioneve sipas pozicionit të punës ku është emëruar, si dhe me ndërprerjen e pagës që nga muaji Qershor 2017”, ka nisur verifikimin e këtij rasti.

Nga hetimi administrativ që është kryer nga Komisioneri, rezulton se, punonjësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës me aktin administrativ nr. 40, datë 1.9.2014, të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, “Për emërimin e përkohshëm të inspektorit në sektorin e inspektimeve të tjera shëndetësore pranë ISHSH, Dega Tiranë”, në

pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimeve të Tjera Shëndetësore*”, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë.

Më pas, me Urdhrin nr. 222, datë 17.3.2015, të Kryeinspektorit, ai është emëruar përkohësisht në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar*”, po në këtë institucion.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, është përfshirë për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1, (numri rendor 58), të Vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar.

Nisur nga ky fakt, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar (data 26.2.2014), në bazë të nenit 22 deri 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore, si konkurrimi, lëvizja paralele apo ngritja në detyrë.

Kjo procedurë, është analizuar në mënyrë të hollësishme edhe në Vendimin nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, i cili është shfuqizuar, por që ishte i zbatueshëm për periudhën në fjalë.

Në rastin konkret, konstatohet se, punonjësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimeve të Tjera Shëndetësore*”, në datën 1.9.2014, sipas aktit të përkohshëm të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit (para emërimit në këtë pozicion, sipas librezës së punës, që nga data 1.11.2012 deri në datën 2.6.2014, ai ka punuar në pozicionin shef i Higjenës së Punës pranë Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë, institucion që nuk është pjesë e shërbimit civil).

Në këtë mënyrë është vepruar edhe për emërimin e tij në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar*”, i cili, sipas ligjit për nëpunësin civil, konsiderohet “*ngritje në detyrë*”.

Nga sa më sipër, Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, pasi siç e theksuam më sipër, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve juridike të ligjit, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Komisioneri vëren se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, çka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor duhet të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke e shpallur si të lirë pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar”, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë, për t`u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 e 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të marrin masat për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë në lidhje me administrimin e shërbimit civil, duke vepruar si më poshtë:
 - ✓ Të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 40, datë 01.09.2014, të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin e punës, “Inspektor në Sektorin e Inspektimeve të Tjera Shëndetësore”.
 - ✓ Të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 222, datë 17.3.2015, të Kryeinspektorit, për emërimin e përkohshëm të punonjësit *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar”, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë.
 - ✓ Të nxjerrin aktin për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me institucionin për punonjësin në fjalë të emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
2. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.

4. Të njoftohen për këtë vendim, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA